

**REBUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI MJEKËSOR - TIRANË**  
**FAKULTETI I MJEKSISË**  
**DEPARTAMENTI I KIRURGJISË**

***DISERTACION***

***i paraqitur nga Ilber Besimi***

*për marrjen e gradës shkencore*

**"DOKTOR"**

Në temë

***"Terapia induktive, tek karcinomi i mushkërive,  
përparsi ne trajtimin kirurgjik dhe terapeutik"***

Udhëheqës shkencor  
***Prof Asc. Fadil GRADICA***

Kandidati  
**Ilber Besimi**

Tiranë, 2022

*Falemnderimi i përket familjes sime të shtrejtë që gjithë kohën më përkrahu dhe më nxiti vazhdimisht në veprimtarinë time.*

*Falemnderim i veçantë është për Prof. Asc. Fadil GRADICA që ishte udhërefyës i ndritur nëpër rrugëtimin tim shkencor.*

*Ju falemnderit*

**REBUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI MJEKËSOR - TIRANË**  
**FAKULTETI I MJEKSISË**  
**DEPARTAMENTI I KIRURGJISË**

***DISERTACION***

***i paraqitur nga Ilber Besimi***

*për marjen e gradës shkencore*

**”DOKTOR”**

Tema

***"Terapia induktive, tek karcinomi i mushkërive,  
përparsi ne trajtimin kirurgjik dhe terapeutik"***

Udhëheqës shkencor

***Prof Asc. Fadil GRADICA***

MIRARTOHET NË DATË \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022 PARA JURISË

- |          |                  |
|----------|------------------|
| 1. _____ | KRYETAR          |
| 2. _____ | ANËTAR (OPONENT) |
| 3. _____ | ANËTAR (OPONENT) |
| 4. _____ | ANËTAR           |
| 5. _____ | ANËTAR           |

Tiranë, 2022

## PËRMABAJTJA:

1. HYRJE	5
2. EMBRIOLOGJIA E MUSHKËRIVE	8
3. ANATOMIA E KAFAZIT TË KRAHARORIT	9
4. MANIFESTIMET KLINIKE TE KANCERIT TE MUSHKERIVE	12
5. PERGATITJA PARAOPERATOREMANEVRUESE TE SISTEMIT RESPIRATOR	27
6. VLERSIMI PARAOPERATIV I PACIENTËVE	30
7. TERAPIA PARAOPERATIVE I KANCERIT TË MUSHKËRIVE	34
8. PERIUDHA INTRAOPERATIVE	38
9. ANESTEZIA PËR KIRURGJIN E KRAHERORIT	42
10. PRERJA TORAKALE STANDARDE	54
11. HEQJE STANDARTË TË SEGMENTËVE TË MUSHKËRIVE	59
12. PRINCIPET THEMELORE TË DRENAZHËS	73
13. KOMPLIKACIONMET E DRENAZHES TORAKALE POSTOPERATIVE	80
14. QELLIMI I STUDIMIT	82
15. MATERIALE DHE METODA	73
16. REZULTATET	87
17. FOTOGRAFI	112
18. DISKUTIMI	117
19. PERFUNDIME	120
20. LITERATURA	122

## 1. HYRJE

Karcinomat e mushkërive ose siç është më drejtë të quhen karcinomat bronkopulmonare, në ditët e sotme, paraqesin një problem shumë të rëndësishëm në praktikën mjekësore të vendeve të ndryshme të botës, pavarësisht se shpeshësia dhe problematika që ato krijojnë luhetet nga njëri vend në tjetrin në varësi kjo të kushteve mjedisore, profesionale, të stilit të jetesës, etj, që mbizotërojnë në njërin vend ose tjetrin. Sidoqoftë ato takohen në përqindje të madhe, kanë vdekshmëri të lartë, mbijetesë të shkurtër, prirje për të prekur moshat e vjetra por edhe të reja, fakte këto që mbështesin arsyen e fortë dhe interesin e madh për t'u marrë me studimin e tyre. Gjithësesi numri i madh e të sëmurëve që vuajnë nga karcinomat e mushkërive, paraqet problem serioz mjekësor, sfide tejet të madhe për stafet multidisiplinore spitalore që angazhohen për të arritur diagnostifikimin dhe trajtimin e këtyre karcinomave. Gjithë studimet e bëra kohët e fundit në ekzaminimin e shkaqeve, trajtimit dhe pasojave të karcinomave të mushkërive i vënë në pah këta vështirësi dhe sfida mjekësore e shëndetësore.

Pikërisht ky kompleksitet dukurish dhe vështirësi kapërcimesh të tyre kanë qenë arsyet që më kanë dhënë idenë, më kanë intriguar dhe më kanë shtyrë t'i zgjedh karcinomat bronkopulmonare si temë të studimit tim. Do mundohem të jap një kontribut qoftë edhe modest në këtë problem të rëndësishëm të patologjisë pulmonare duke u bazuar, analizuar dhe shqyrtuar rastet dhe kushtet e institucionit mjekësor nga ku është mbledhur materiali studimor.

Zhvillimi industrial që pasohet me ndotje të mjedisit jetësor, levizjet e mëdha demografike që ka për rezultat përqëndrimin e popullatës në qytete, zhvillimi i shpejtë i komunikacionit urban dhe ndërrurban, dhe sidomos rritja e numrit të personave që pinë duhan, janë faktorët më të rëndësishëm etiologjik për karcinomat pulmonare. Mjaft të përmendim se pirja e duhani akuzohet se është përgjegjëse për rritjen e rrezikut për zhvillimin e karcinomave të mushkërive. Pa mohuar këtu edhe rolin e faktorëve të tjerë si ndotja e mjedisit jetësor e profesional, hereditar, etj. Përmbledhtazi mund të thuhet se karcinomat e mushkërive diagnostifikohen me vonesë, përfaqsojnë shumë raste inoperabiliteti, kanë vdekshmëria të lartë dhe mbijetesë pesëvjeçare të vogël. Shkurt janë patologji të rënda dhe me mjaft problematike.

**Në pikëpamjen histologjike dallohen disa forma të karcinomave të mushkërive, ndër të cilat më kryesoret janë:**

- 1) Carcinoma planocelulare (epidermoid ose skuamoze) me variantet kornifikante (më e diferencuar dhe jo kornifikante (më pak e diferencuar);
- 2) Adenokarcinoma (carcinoma glandulare);
- 3) Carcinoma me qeliza të mëdha (makrocelulare);
- 4) Carcinoma me qeliza të vogla (mikrocelulare ose small cell carcinoma ose oat cell carcinoma që do të thotë carcinoma me qeliza si qelizat e tërshërës);
- 5) Carcinoidi, etj.

Shpesh simptomatologjia e përgjithshme e karcinomave të mushkërive, i ngjanë asaj të një pneumonie, pra të një ftohje të thjeshtë që nuk u tërheq shumë vëmendjeve të sëmurëve dhe për këto shkaqe nuk i drejtohen mjekut, sepse nuk mendojnë se kanë një sëmundje të rëndë dhe se ajo do të kalojë pa mjekim ose qoftë edhe me një mjekim të thjeshtë. Përkundrazi duhet të jetë e qartë se bëhet fjalë për një patologji të rëndë, e cila duhet diagnostikuar sa më shpejt, duhet vlerësuar seriozisht dhe duhet mjekuar fort. Diagnostifikimi sa më i hershëm i karcinomës të mushkërive paraqet një imperativ të dorës së parë. Duhet të jetë e qartë se trajtimi që në stadet e hershme dhe me protokolle të përcaktuara mirë të karcinomave të mushkërive është shumë më rezultativ dhe siguron një prognozë mjaft më të mirë të sëmurit.

Ndër metodat më të efektshme të mjekimit të karcinomave të mushkërive ai kirurgjikal është konsideruar si më i preferuar dhe shpesh si një nga qasjet e vetme që në fund të shekullit XX dhe në fillimin e këtij shekulli. Ndërkaq trajtimi me anë të protokolleve të reja e bashkëkohore ka marrë gjithnjë e më shumë një qasje multidisiplinore, në këto patologji të rënda e të rrezikshme. Në trajtimin modern të karcinomave të mushkërive punojnë në bashkëpunim një numër i madh specialistësh, duke filluar nga mjekët e familjeve, pneumologët, patologët, kirurgët thorakalë, anesteziologët e reanimatologët, onkologët duke përfshirë edhe punonjësit socialë. Tërë këta specialist punojnë me një sistem zinxhirë e të koordinuar mirë me njëri tjetrin. Sidoqoftë pikë kryesore orientimi i tërë këtyre specialistëve është tipi histopatologjik i karcinomës dhe stadi i zhvillimit të tij. Por nuk duhet harruar se mjekimi kirurgjikal i një të sëmuri me karcinomë të mushkërive nuk duhet ndërmarrë kurrë pa bërë më parë një vlerësim të mirë të gjendjes të përgjithshme të organizmit e sidomos të sistemit kardivaskular dhe korigjimi i çrregullimeve që ky system mund të ketë.

Trajtimi i karcinomave të mushkërive nuk ka të bëjë thjeshtë e vetëm me zgjidhjen e problemeve mjekësore, por edhe të atyre sociale, që kanë të bëjnë me përmisimin e kualitetit të jetës së pacientit, me riakomodimin e tij në jetën e përditshme dhe në kushtet profesionale. Rehabilitimi sa më i plotë dhe rikëthimi sa më i sukseshëm në jetën normale, është plotësimi i suksesit. Rëndësi të madhe ka puna e specializuar psikologjike me pacientin për mirëkuptimin e gjendjes së re të krijuar në kuptimin e përkushtimit të pacientit për të zbatuar trajtimet e zgjatura dhe jo pa ndërlikime të mundshme.

Nga sa u tha kuptohet se në vitet e fundit, trajtimi i kancerit të mushkërive është përmirësuar shumë. Megjithatë kjo nuk ka sjellë përmirësim në performancën e mjekimit më shumë se në 15% pacientëve. Përparime në trajtimin e karcinomave të mushkërive bazohet kryesisht në vlerësimin e sistemit TNM në përcaktimin e indikacioneve për ndërhyrje kirurgjikale, përdorimi i terapisë së kombinuar në disa situata klinike, përcaktimi i fushës së radioterapisë si dhe futja në përdorim e skemave më efektive kimioterapeutike. Rol të madh në arritjen e rezultateve positive në trajtimin e karcinomave të mushkërive ka përdorimi sa më i gjërë i screening-ut, tipizimi gjenetik i të sëmurëve etj.

## 2. EMBRIOLOGJIA E MUSHKËRIVE

### *2.1. Periudhat e zhvillimit embriologjik të mushkërive*

Diferencimi i mushkërive nisë bashkë me gjithë organet e tjera por roli funksional i tyre fillon menjëherë pas lindjes së foshnjës. Ja pse të marrunit frymë është njëri prej kritereve kryesore që dëshmon se fëmija ka lindur gjallë.

Zhvillimi embriologjik i mushkërive kalon nëpër disa faza, të cilat, nga më e hershmja për te më e vona janë: *Faza embrionale, pseudogladulare, kanalikuare, e sakuseve terminale dhe alveolare*

- *Faza Embrionale*
- *Faza pseudogladulare*
- *Faza kanalikuare*
- *Terminal-sekulare*
- *Faza alveolare*

### *Zhvillimi i inervimi të mushkërive*

Inervimet fillestare simpatike dhe parasimpatike vërehen nga java e 6 e zhvillimit të fetusit

### *Zhvillimi i shpraztirës pleurale*

Krahas diferencimit të organeve aty nga java e 4 e zhvillimit intrauterin shpraztira e përbashkët e trupit të fetusit ndahet në dy pjesë: shprazëtira abdominale dhe ajo torakale dhe më pas nis të formohet shpraztira pleurale në proporcion me zhvillimin dhe diferencimin e pulmonit. Preardhjen pleura e ka nga pjesa mezodermale laterale.



### **3. ANATOMIA E KAFAZIT TË KRAHËRORIT**

Struktura kockore që e përbëjnë kafazin e krahërorit siguron mbrojtjen e organeve që ai përmban. Nga pas kafazi i krahërorit kufizon prej pjesës torakale të shtyllës kurrizore (Th1 - Th12). Në të dy anët e kolonës vertebrale dalin 12 çifte brinjësh në formë gjysëmharku që në pjesën e parme përfundojnë tek sternumi, kështu që formojnë një kafaz mirë të kufizuar dhe stabil. Në pjesën e poshtme e birnjëve kalojnë arteriet dhe v. intracostalae, të përcjellura me nervin intrakostal përkatës.

Në pjesën e sipërme të pasme të kafazit të krahërorit struktura kockore përmban edhe shpatulën nga të dy anët ndërsa nga ana e përparme strukturës kockore të kafazit të krahërorit i bashkëngjitet edhe claviculat nga të dy anët. Në pjesën e poshtme shpraztura e toraxit mbyllet me diafragmën që bën separimin e kafazit të toraxit me atë abdominal.

#### **3.1. Anatomia e mushkërive**

Mushkëritë paraqesin organi qëndror të sistemit respirator. Ato janë e majtë dhe e djathtë strukturalizmi i të cilave paraqesin disa dallime. Mushkëritë e djathta janë më të mëdha se ata të majta ndërsa për nga përbërja gjithashtu vërejmë ndryshime në kuptim të përmbajtjes së sasis së lobuseve. Kështu mushkëritë e djathta përbëhen nga 3 lobe (atë të sipërm, të mesëm dhe të poshtëm) gjithashtu në këtë anë më shpesh hasim dy fisura apo septume që i ndajnë lobet mes veti. Mushkëria e majtë përbëhet nga dy lobe atë të sipërmë dhe të poshtëmin që mes vete ndahen me incizurën e madhe.

##### **3.1.1. Segmentet Bronkopulmonale**

Segmentet bronkopulmonare paraqesin njësinë themelore anatomike, funksionale dhe kirurgjikale, që është pjesë më vete në lobin pulmonary. Segmenti ka bronk, furnizim arterial dhe drenim venoz dhe paraqet njësi shumë me rëndësi në pjesën e anatomisë topografike për qëllime kirurgjikale. Më shpesh në të dy mushkërite kemi gjithsejt 18 segmente nga të cilët 10 në anën e djathtë dhe 8 në anën e majtë të disseminuar nëpër lobe si vijon:

Në lobin e djathtë të sipërmë dallojmë 3 segmente:

- Segmenti Apikal, segmenti Posterior dhe segmenti Anterior

Në lobin e mesëm të djathtë dallojmë 2 segmente:

- Lateral dhe Medial

Në lobin e poshtëm të djathtë dallojmë 5 segmente:

- Apical, Mediobazal, Anterobazal, Laterobazal dhe Posterobazal

Në lobin e sipërm të majtë dallojmë 4 segmente:

- Apiko-posterior, Anterior
- Superior lingulae dhe Inferior lingulae

Në lobin e poshtëm të majtë dallojmë 4 segmente:

- Segmenti Apical, Anteromediobazal, Laterobazal dhe Posterobazal

Strukturimi i tillë anatomik dhe topografikoanatomik paraqet udhërefyës apo bazë për trajtimin kirurgjikal të mushkërive. Heqja kirurgjikale e secilës pjesë të mushkërive mund të bëhet duke njohur mirë strukturën anatomike dhe pas identifikimit të strukturave anatomike gjatë kurimit kirurgjikal.

Gjithësesi ndarja anatomike e mushkërive në komunikimin ndërmjeksor na mundëson një unifikim të mirfilltë të komunikimit dhe mirkuptimit në praktikën mjekësore, njëherit shërben edhe për marjen e vendimeve për trajtime qoftë ata kurative apo paliative në paraqitjen e sëmundjeve të ndryshme të mushkërive. Por duke mos i lënë pas dore apo në minimizimin e rëndësisë të brokeve si qëndror ashtu edhe të atyre lobulare segmenta e bronkiolve si the të trakesë që së bashku krijojnë një tërësi funksionale të sistemit respirator.

Strukturë me rëndësi si anatomike ashtu edhe funksionale e në veçanti edhe kirurgjikale është mediastinumi dhe hilusi i mushkërive ku strukturat që futen apo kalojnë aty janë me rëndësi të jashtëzakonshme në praktikën kirurgjikale. Në hiluset e të dy anëve dallohen disa ndryshime.

<p>Në pjesën e mediastinumit dhe hilusit të djathtë vërejmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Bronku qëndror i djathtë</li> <li>▪ Arterja pulmonale</li> <li>▪ Vena pulmonale</li> <li>▪ Nervus phrenicus</li> <li>▪ Vena azygos</li> <li>▪ Plexus simpaticus</li> </ul>	<p>Në pjesën e mediastinumit dhe hilusit të majtë vërejmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Bronki qendror i majtë</li> <li>▪ Arterja pulmonale e majtë</li> <li>▪ Vena pulmonale e majtë</li> <li>▪ Nervus phrenicus</li> <li>▪ Plexus simpaticus</li> <li>▪ Truncus brachiocefalicus</li> <li>▪ Aorta</li> <li>▪ Diafragma</li> <li>▪ Nervus vagus</li> </ul>
--	---

Rëndësi të veçantë kirurgjikale paraqesin edhe gjëndrat limfatike të mushkërive dhe të mediastinumit, ku paraqesin pjesë në vlersimin e nivelit të sëmundjeve pulmonale si dhe futen edhe në trajtimin apo më sakt në kurimin kirurgjikal. Mënjanimi i gjëndrave limfatike në trajtimin onkologjik të të sëmurëve luajnë rolin e tyre të rëndësishëm në përzgjedhjen e protokollit kirurgjikal.

Gjëndrat limfatike ndahen në dy grupe të mëdha ata:

- ▶ Gjëndrat limfatike pulmonale
  - o Intrapulmonale
  - o Bronkopulmonale
  
- ▶ Gjëndrat limfatike mediastinale
  - o Gjëndrat limfatike mediastinale të përparme
  - o Gjëndrat limfatike mediastinale të pasme
  - o Gjëndrat limfatike mediastinale trakeobronkiale

#### **4.1. MANIFESTIMET KLINIKE TË KANCERIT TE MUSHKËRIVE**

Shpesh vihet re një hije radiologjike që krijon mundësi për të dyshuar ekzistenca e kancerit të mushkërive. Fakti që një kuadër i tillë vihet re në një të moshuar e shton dyshimin për mundësinë e ekzistencës së kancerit. Me shume se 90% m të rasteve simptomat dhe shenja të sëmundjes lidhen me sëmundjen apo gjendjen patologjike me të cilat lidhet lindja e kancerit. Shumica e shenjave lidhen me veprimet lokale, rajonale ose sistematike te kancerit (në sy 27% e pacienteve, 32% janë manifestimet e metastazave dhe 34% janë manifestime të ndryshme sistematike, si dobesi e pergjithshme humbja e peshes trupore dhe anoreksija. Nje numer i papërfillshëm i pacientëve me kancer të mushkërive zbulohen rastesisht me ekzaminime imazhërike, i ashtuquajhuri kanceri akut

Karakteristikat biologjike të kancerit krijojnë sindroma paraneoplastike me polimorfizëm simptomatik.

#### **4.2. SIMPTOMATOLOGJIA E KARCINOMAVE E MUSHKERIVE**

##### ***4.2.1.Simptomat bronkopleumonare***

si pasojë e rritjes qendrore dhe periferike fillestare të tumorit. Këto ndodhin si pasojë e rritjes dhe përhapjes të tumoreve bronchial ose pulmonar.

Lokalizimi primar i kancerit të mushkerive mund të jetë qendror dhe periferik .Tumoret qendrore rriten në degën bronkiale kryesore lobale. Lokalizimi qendror është karakteristik për tumorin me qeliza squamoze dhe për atë microcelular.

Tumoret me lokalizim periferik shkaktojnë pak simptoma të cilat janë pasojë e zgjerimit të nyjeve limfatike medijasternale megjithat, shjena e parë e sëmundjes mund të jenë simptomat pleurale, bronkopleumonare simptomat ndoshta zhvillohen si rezultat i ulceracioneve, i bllokimit të bronkeve ose një kombinim i të gjitha komplikimeve në parenkimën e tumorit.

#### ***4.2.2. Siptomat ekstrapulmonal intratorakale,***

Simptomat intratorakale ekstrapulmonare shkaktohen nga përhapja e kancerit të mushkërive duke pushtuar drejtpërdrejtë strukturat përreth, dmth organet si pleurën parietalstrukturat mediastinale apo strukturën nervore të gjoksit. Përhapjet kryesisht bëhen nëpërmjet enëve limfatike duke dhënë metastaza limfatike regjionale si në hilusin pulmonar dhe në rrjetën mediastinal limfatik duke zgjeruar hilusni dhe duke zmadhuar nyjet limfatike mediastinale. Mirëpo zmadhimi i limfonoduleve mund të jetë rezultat i infeksioneve. Nyjet limfatike të zgjeruara mund të kompresojnë ezofagun dhe venën kava dhe të shkaktojë një ndjenjë e presioni retrosternal dhimbje gropa supraclavicular janë ku nyjet limfatike zgjeruar më e lehtë për njoftim dhe Preket fëmija në këtë PROTOR mund të krijojë nyjet limfatike zgjeruar në 15-20% të pacientëve me kancer të mushkërive limfatike çfarëdoshëm nyjet janë të prekur më shpesh, por me ta shumë shpesh pozitiv kur tumori është i lokalizuar në skajin e sipërm metastases pozitive duke gjetur në nyjet limfatike të qafës së mitrës përfaqëson shumica e pacientëve të nënshkruajë. tumoret pankoast janë shënuar si tumoret e sulcus sipërme-superiore. ata janë të mirë neoplasms kufizuar dalin në pjesët e prapme të majat e lobes e sipërme pranë pleksus cervicobrachial. Prania dhe rritja e tumorit shkakton simptoma dhe shenja që rezultojnë nga rritja infiltrative. Pacientët ankohen për dhimbjen e supit në gjysmën e dorës dhe sipërfaqen e brendshme të krahut të sipërm ose në të gjithë gjymtyrët e sipërme. Atrofia e muskujve ekziston në rajonin e supeve dhe muskujt e krahut të prekur. Simptoma të tilla ekzistojnë në deri në 4% të pacientëve me kancer të mushkërive. Nuk është e pazakontë që simptoma të zgjasë deri në një vit para zbulimin të kancerit. Diagnoza aktuale e këtyre tumoreve është i bazuar jo duke përdorur rezonancë magnetike bërthamore, ajo është më e besueshme se tomografia. Shumica e kancereve janë të tipit me qeliza squamoze. Ata rriten ngadalë dhe metastases të ndodhë më vonë. Kur tumori penetron pleurën dhe përhapet në murin e kraharorit mund të shkaktohet shkatërrimin e brinjës së parë dhe të dytë gjë që intensifikon dhimbjet. Gjithashtu mund të ndodhë shkatërrimi i trupit vertebral.

### **4.2.3. Simptoma ekstratorakale,**

#### **4.2.3.1. Sindromaet paraneoplastike**

Tërmini "sindromet paraneoplastike" nënkupton simptome dhe shenja të manifestimeve sistemike të tumorit të cilat ndodhin larg nga vendi i tumorit primar ose metastazave të tij. Ky sindrom ndodh për shkak të prodhimit të faktoreve sistemik nga ana e tumorit p.sh. hormonë polipeptid, antitruptive imunokompleksëve, prostaglandinëve ose citokinëve. Ai haset tek 10-20% e të sëmurëve me karcinom të mushkërive. Në disa raste është vështirë të diferencosh pasojat e neoplazmes nga ato të sindromit paraneoplastik. Ky sindrom mund të jetë i maskuar me paraqitjen e metastazave të vogla, efektin e dobët të terapisë së aplikuar, komplikimet vaskulare, disbalansin elektrolit etj. Simptomat e këtij sindromi nuk duhet të korelojnë me madhësinë e tumorit primar ata mund të paraqiten edhe tek gjendje të dijagnostifikuara ose të jenë shenjë e parë e recidivit të sëmundjes. Manifestimet klinike mund të jenë të lehta sistemike ose kutane (lëkurore) deri tek hiperkoagulopati ose neuromiopati të rënda. Ky lloj sindromi është më e shpeshtë tek forma mikrocelulare dhe skvamocelulare e tumorit të mushkërive. Mjeku klinik duhet ti njohë shenjet klinike që të zbulohen pacientët që mund të operohen, por për fat të keq zbulimi ndodh gjithmonë në fazat e avancuara të sëmundjes kur ajo është e paoperueshme.

#### **4.2.4. Sistemi endokrin-metabolik**

Janë zbuluar disa sindroma paranëoplastike me manifestimet endokrin-metabolike ndër më të njohurat janë:

##### **4.2.4.1. Sindroma Cushing**

Ky sindrom më shpesh paraqitet tek karcinomi mikrocelular. Ai zhvillohet për shkak të prodhimit të një substance të ngjajshme me hormonin adrenikortikotrop. Prodhimi i hormonit është autonom dhe nuk është i mundur suprimimi me dexametason. Sekretioni ektopik i hormonit haset tek të sëmurët në një përqindje të lartë 30-50% por vetëm tek 2% kemi shenja klinike të Cushing sy. Megjithatë rallë shihet pamja karakteristike klinike e të sëmurët. Simptomat janë kryesisht metabolike-alkaloze e rënde, hipokaleristike me një dobësi progressive ose hipoglikemi. Diagnoza

vendoset nga vlerat e ritura në gjak të hormonit. Pas hemoterapisë pacientët nga infekcionet oportune. vdekja shpesh vjen para se të ndodh efekti i terapisë me citostatik.

#### **4.2.4.2. Hiperkalcemia jometastatike**

Hiperkalcemija tek karcinomi mund të vije si pasojë e osteolizes së kockave ose nën ndikimin e faktoreve humoral atëhere është niveli i Ca në serum i ritur, ndersa nuk egzistojnë depozite metastatike në kockat. Reth 10-15% e pacientëve me karcinom skvamocelular zhvillojnë hiperkalcemi gjatë sëmundjes. Kjo paraqitje është e rralle tek format tjera të karcinomit që shpesh metastazojnë në kockat. Për hiperkalceminë është përgjegjese sekrecioni ektopik i substances të ngjajshme me parathormonin. Diagnoza vërtëtohet me gjetjen e hipofosfatemisë në gjak dhe rentgenografinë ose scintigrafinë e eshtrave si shenja klinike kryesisht dominojnë simptomet neurologjike dhe dehidrimi. Të sëmurët janë konfuz. kanë kokëdhimbje janë të përgjumur dhe letargjik. ndersa koma mund të jep përshtypjen e metastazave në tru. Shpesh ka shenja edhe nga trakti gastrointestinal si anoreksi. gerditje, vjellje, kapsllek etj. Këta të sëmurë kanë tumor që operohet. Niveli ca pas heqjes së tumorit normalizohet Keta pacientë shpesh kanë recidiv të sëmundjes.

#### **4.2.4.3. Sindromi sëkrecionit joadekuat të hormonit antidiuretik**

Njelloj si sy. cushing, kur bëhet fjale për hormonin adrenokortikotrop(ACTH), niveli i hormonit antidiuretik është i rritur tek 70% të sëmureve, por pak nga ato kanë shenja klinike. Simptomët më shumë takohen tek të sëmurët me karcinom mikrocelular. Ata shpesh kanë hiponatremi osmolar të lartë të urinës. kanë anoreksi, vjelje, konfuzion, sulme epileptike. Që ka të bëjnë me restriksion të lëngjeve, ndërsa në rastet e rënda jepet tretje hipertoniqe e NaCl.

#### **4.2.4.4. Prodhimi ektopik i gonadotropinëve**

Ndonjëherë ndodh që të sëmurët me karcinom të mushkërive të zhvillojnë ginekomasti të dhimbshme (ritje e gjinjëve). Ajo mund të jetë e njëanshme ose dyanshme, më shpesh në anën që gjendet tumori. Më e shpësthtë është te format mikrocelulare të tumorit dhe është pasojë e vlerave të rritura të horiongonadotropinit.

#### **4.2.4.5. Miopatië dhe sindromet neurologjike**

Janë sindromet më të shpështa plastike tek karcinomi mushkërive. Por qe të vendoset diagnoza për ata më parë duhet të eliminohen manifestacionet tjera të sëmundjes , siç janë metastazat në sistemin nervor qendror. Çrregullime cerebrovaskulare, efektet e imunitetit të zvoglar pas hemotërapisë ose gjendjet me infeksion.

#### **4.2.4.6. Miopatië karcinomatoze**

Keta syndrome janë të shpeshta. Egzistojnë dy forma:

-Sindromi miastenik është i përshkruar si sy. miastënik i Lambert-Itan cili paraqitet kryesisht tek forma mikrocelulare e tumorit më shpesh tek gratë reth 6% Karakteristika kryesore sindromit është çrregullimi përclëlljes neuromuskulare, për çka si pasojë është lodhja dhe dobsimi i muskujve të ekstremitëtëve dhe sidomos atyre të legenit kofshave. Sindromi është pasojë lirimit të çrregulluar të e acetil-kolinës në mbaresat nërvore.

- Poliomyoziti ngjan shumë sindromit miastenik por humbja e forcës muskulare është më e madhe dhe e shpejtë, vjen deri tek degjenerimi i fijeve muskulare.

#### **4.2.4.7. Neuropatia periferike**

Gjendjen e karakterizon humbja e senzibilitetit. i paraprijnë dhimbje dhe parestenzion deri në humbjen e plotë të ndjeshmerisë në ekstremitetet e poshtme. Rallë paraqitet e izoluar, shpesh është e kombinuar me humbjen muskulore dhe atrofinë e muskujve. Egzaminimet neurologjike flasin për humbje të sensoriumit (ndjeshmërisë) në mbaresat nervore dorzale të medulla oblongata (palces).

#### **4.2.4.8. Degjenerimi cereblar subakut**

Tek të sëmurit qe kanë kështu çrregullime shpejt ndodh humbja e funksionëve të trurit të vogël. Karakteristike është ataksija, humbje e koodinimit në levizje, maramendje, nistagmus dhe disartri. Në trurin e vogel ndodh dëmtimi i fijeve të purkinit si dhe procese tjera degjenerative.

#### **4.2.4.9. Encefalomielopatia**



Përfshin nje paletë të çregullimeve psikiatrike siç janë demencioni, humbja e memorisë ose sjellje e çoroditur. Mund të paraqitet simptome të rrugës piramidale dhe paralizë pseudobulare. Nëse është atakuar palca simptomet mvaren nga distribuimi i lezionëve në të.

#### **4.2.4.10. Retinopatia karcinomatike**

Humbja e shpejtë e shiqimit binocular (me dy sy) ndodh shumë ralle. Si paraqitje më e shpeshtë është te karcinomi mikrocelular. Humbjes të shiqimit i paraqitën fotosensitiviteti dhe paraqitja e skotomeve (hijeve) në fushen e të pamurit.

#### **4.2.4.11. Sindroma Horner,**

E cila është shkaktuar nga invazioni i tumoreve në zinxhirin simpatik dhe Gaglion stellatum. Ajo karakterizohet nga shfaqja e ptosis, enoftalmus i njëanshëm, miosis dhe anhidrosis e fytyrës ipsilateral dhe gjymtyrëve të sipërme. Ekzaminimi fizik për të përcaktuar atrofi të muskujve, dobësi dhe humbje të reflekseve, etj.

#### **4.2.4.12.Sindromi i venave superiore**

Shkaktohet nga kompresioni i venave nga tumori dhe rrallëherë shkaktohet nga tromboza. Pengimi i venave mund të jetë akut ose subakut dhe në shumicën e rasteve mund të shkaktohet tumore intrathorakal malinje primarë apo metastatik (në rreth 90% e rasteve) ose nga limfomat. Kanceri i mushkërive është shkaku i sindromës në rreth 46-75 % të rasteve . Pamja e jashtme e pacientëve me sindromin e kompresionit të venës kava superiore karakterizohet me edemë dhe zgjerim të fytyrës. Fryrje në gjysmën e sipërme të krahavorit dhe të gjymtyrëve të sipërme. Rrallë shfaqet edhe cianoze e gjysmës së sipërme të trupit. Shfaqet dispne, kollë, disfagi, etj. Pengimi i venave cava superior mbi hedh. azygos karakterizohet nga distension e venat e qafës dhe në krah dhe edemë e fytyrë, qafë dhe të armëve. nuk ka mbulesë mukoza me kolaterale Dilated deje gjarpërues gjysmën e sipërme të gjoksit. nëse skajor pengesë për v.azygos hedh zhvillon formë klinikisht më të rëndë të sindromi. Venat kolateralit janë të dukshme në murin e barkut e përparme dhe e pasme, sepse gjaku ka për të arritur në gjysmën e djathtë të zemrës nëpër vena Cava-përcaktim. Sindromi caval superiore vena pengesë shkaktohet zakonisht nga qeli të vogël mushkërive Kanceri ndjekur nga tumor qelizë squamous. në 40% të pacientëve, nuk është sëmundje e kufizuar dhe pjesa tjetër ka zgjeruar sëmundje. në pacientët me këtë sindrom është

metastaza të përbashkëta të trurit më shpesh se kanceri i mushkërive tjetër. Përfshirja . recurens dhe n.pharencius një ngjirurit e zërit dhe paraliza e një hemidiaphragm janë të rralla në fazën fillestare të sëmundjes prej 5% dhe 1% . megjithatë , kursi klinik i Cassini , dy fenomene janë parë si një shenjë e progresin e sëmundjes . ngjirurit e zërit është shkaktuar nga pushtimi i mbathje përsëritura laryngeal ose një tumor primar të lob e sipërm të majtë . pushtim ose ngjeshja e këtyre nervave mund të ndodhë edhe në dritaren aortopulmonalnom për shkak të praninë e metastazave të nyjeve limfatike . pjesa e majta nervore e përsëritur e regjinit laryngeal është më shumë se rastet e tjera, sepse rreth harkut të aortës në dritare të aortës . në anën e djathtë të nervit është kontakti i lartë , përgjatë arteries, me në krye të mushkëritë. N.phrencius mund të preken nga kanceri njësoj. Kur kjo ndodh nuk është një karakteristikë lartësi radiografike hemidiaphragme gjatë një frymë paqësore ose kollitjes . paraliza e diafragmë rezulton në një rënie në kapacitet jetike dhe mund të jetë arsyeja për paraqitjen e dyspnea .dhimbje në gjoks -dhimbje kraharorit dhimbje gjoksi është një simptomë e zakonshme e sëmundjes . Ai duket zhvillimin tokok e sëmundjes në më shumë se gjysma e pacientëve . Dhimbje kraharorit është e shurdhër , me ndërprerje dhe nganjëherë të mprehta dhe mund të zgjasë nga disa minuta në disa orë . dhimbje pacienti nuk është i lidhur tek faza e frymëmarrjes. lokalizimin e dhimbje në shumicën e pacientëve në tench lartë kafaz brinjë në anën ku tumor në mushkëri . dhimbje e fortë dhe këmbëngulës kraharorit , e cila është e lokalizuar dhe është në përputhje me pushtimin e drejtpërdrejtë e tumorit përmes pleurë parietal apo më thellë në strukturën e murit gjoks . Nuk është një dhimbje e tillë në adenocarcinoma periferike të mushkërive .dhimbje shkaku dhe supe mund të jetë Pancoast tumor apo tumore që janë në skajin më të ulët të trurit që pushtonin pjesën qendrore të diafragmë . dukuri e dhimbje kraharorit mund të jetë për shkak të ngjeshjes së tumorit arteries pulmonare apo nyjet limfatike zgjeruar . dhimbje gjoksi shpesh të shoqëruara me Clubbing e kollë dhe dyspnea.

#### **4.2.5. Kolla:**

Më zakonisht shfaqet kollë e thatë, ajo ndodh në rreth 75% të pacientëve. Shumica e pacienteve janë duhanpirësit dhe për këtë arsye ajo mund të neglizhohet sipse lidhet me duhanin apo bronkitit. Një arsye tjetër e kollës kompresioni bronkial që mund të jetë extraluminal ose intraluminal.

#### **4.2.6. Dispnea,**

Për nga shpeshtësia, është simptomë e dytë në të sëmurët me karcinoma të mushkërive. Ajo takohet në 50% -60 % të pacientëve me kancer të mushkërive. Në tumoret e lokalizuara në nivel qendror dispnea është rezultat i mbyllje të pjesshme ose të plotë të bronkut, me atelektazë shoqëruese. Dyspnea mund të lidhet me çrregullimet e rrjedhjes limfatike (limfangiomatozë carcinomatoze).

#### **4.2.7. Gulçitja;**

Ndodh kur tumori mbyllë pjesërisht bronkun proksimal dhe më shpesh dëgjohet kur diametri udhëve ajrore është reduktuar në më pak se 50% të kalibrit të tij.

#### **4.2.8. Stridor ;**

Është rezultat i pengesaës pothuajse të plotë të pjesës proksimal të bronkut kryesor ose pjesë trakeje.

#### **4.2.9. Hemoptizia;**

Ndodh në rreth 25-40 % të pacientëve. Përfaqësojnë një nga manifestimet më të rëndësishme klinike të kancerit të mushkërive . mund të jetë e vetmja shenjë e sëmundjes në pacientët me gjetjet normale në radiografi të gjoksit. Kjo vlen veçanërisht për personat më të vjetër se 40 vjet. Sasia e gjakut zakonisht është minimale dhe gjaku që eliminohet duket e freskët Hemoptizia është karakteristike për tumoret qendrore të lokalizuara . gjakderdhja është për shkak të rritjes së invazionit neoplazik dhe ulcerimit të paretit të bronkut. Hemoptizia mund të jetë edhe massive, por kjo është më e rrallë. Ajo gjithashtu rrallë ndodhë në metastazë extrapulmonare të karcinomave. Sidoqoftë duhet bërë kujdes se hemoptizia mund të jetë një shenjë e sëmundjeve të tjera si tuberkulozi, stenoza mitrale, bronkit, infarkt pulmonar dhe bronhiektazija.

#### **4.2.10. Simptomat pneumonike:**

Ndodhin si rezultat i ekzistencës së njëkohshme i atelektazisë postobstruke, bronkitit ose pneumonisë. Simptomat zakonisht janë të kombinuara me kollë, dispnoe, hemoptizi, dhimbje pleurale, etj.

#### 4.2.11. Abscesi pulmonar:

Zakonisht ndodh si rezultat i nekrozës dhe inflamacionit bacteria të masës tumorale. Ai është më e zakonshme në tumor me qeliza squamoze dhe me qeliza të mëdha.

Në momentin e diagnostifikimit të sëmundjes, ka disa karakteristika themelore të karcinomit të mushkërive që janë:

- Diagnostifikim i vonshëm,
- Shkallë e lartë e inoperabilitetit,
- Vdekshmëria e lartë dhe
- Shkallë e vogël e mbijetesës pesëvjeçare.

Diagnostifikimi i vonshëm i karcinomit të mushkërive, bëhet si rezultat i mosegzistimit të screeningut të mirëfilltë, për diagnostifikim të hershëm të karcinomit të mushkërive.

Gjatë ndekjes së protokoleve bashkëkohore që ndiqen dhe përdoren si udhërefyes në përditshmërinë e trajtimit kirurgjik të pacientëve me karcinom të mushkërive për të bë diagnostifikimin e karcinomit të mushkërive në mënyra profesionale dhe në pajtim me trendet dhe rregullat e mjeksisë së bazuar në dëshmi, bëhet me një sërrë egzaminimesh apo metoda diagnostike me teknika të ndryshme duke ndjekur gjithsesi algoritmin e veprimeve të protokoleve bashkëkohore që gjithsesi niset me:

- RTG grafi native të mushkërive
- Bronhoskopi me biopsi (brushing, biopsi transbronhiale etj)
- CT (seri native dhe me kontrast)
- MRI (magnet resonance imaging)
- Biopsi transtorakele
- VATS (video assistance thoraxes scope)

*për karcinomit të mushkërive vetëm me qëllime diagnostifikimi*

- Torakotomi explorative me biopsi ex-tempore.

Pacientët që u përzgjedhën në këtë studim, pasi që të gjithë kishin udhëzim nga ndonjë mjek specialist i lemive të kirurgjisë, pulmologjisë apo mjeksisë familjare tek të gjithë u vazhdua me metodologjinë tonë të diagnostifikimit.

Së pari tek të gjithë u nënshtruan rentgenografisë native të mushkërive me profil, ku prisnim të shohim dhe vërejtëm ndryshime në strukturat pulmonale. gjë që më tutje më deturoi të vazhdojmë me egzaminimet e tjera.

Pësoji egzaminimi me Tomografi kompjuterike të gjokosit në seri native dhe me kontrast intravenoz - Tomografija Kompjuterike u bë me qëllim të vizuelizimit më të mirë, të ndryshimeve në mushkëritë, të pacientëve ne seri native dhe kuptohet më pas me aplikimin e kontrastit intravenoz, vizuelizimi i vaskularizimit të mushkërive, me theks të veçantë në mundësinë e vizuelizimit, të vaskularizimit patologjik të masës tumoroze. Veprim që në masë të madhe na jepë mundësin, e vlerësimit adekuat të progresit të sëmundjes, pamjen e masës tumoroze dhe infiltrimit e saj ne strukturat përreth.

Veprim diagnostik, që na dha nje pamje dhe vlersim shum të mirë, të avansimit të karcinomit të mushkërive tek pacientët, dhe drejtim të veprimeve të mëtutjeshme diagnostike.

Tek një grupë tjetër të pacientëve, tek të cilët u bënë egzaminimet si rentgenografi native e tomografi kompjuterike, e nuk kishim nje vlrsim dhe pasqyrim të qartë, për sëmundjen dhe stadin e saj, ku ne si ekip mjeksor kishim dilema për avansimin e sëmundjes, pacientët, nje numër shum i vogël, u nënshtrua edhe egzaminimit me rezonancë magnetike, ku vizuelizuam në masë të madhe kuptohet indet e buta, të gjoksit por me theks të veçantë, ne vizuelizimin e mediastinumit dhe gjëndrave linfatike mediastinale.

Më pas tek pacientët, u nënshtruan egzaminimeve pulmonale, ne Klinikën e pulmologjisë dhe vlersimit, të rezervave pulmonale dhe gjithsesi të Bronhoskopise, ku njeherit u be edeh biopsi, qofte ajo me gjilpërë, kiretim apo furçë, material biologjik që më vonë, u përdor për vlersim histologjik të ndryshimit pulmonal.

Tek pacientët ku ndryshimi, apo masa tumoroze nuk na jepte mundësi që të bëjmë biopsi me anë të bronhoskopisë, aty pacientët u nenshtruan biopsisë transtorakale me gjilpërë të hollë. Veprim nga i cili njësoj u morë material biologjik nga masa tumoroze për egzaminim patohistologjik dhe diferencim të karcinomit të mushkërive.

Në një grup shumë, të vogël të pacientëve, të këti studimi edhe pas ushtrimit të metodave diagnostifikuese të lartpërmenduara, nuk kishim diagnozë të qartë, për tipin apo stadin e

sëmundjes dhe kuptohet, vazhduam me metodat që i kishim në dispozicion dhe këta pacient, i nënshtruar në VATS (video assistance thoraxes scopia), me qëllim të diagnostifikimit dhe biopsisë së tumorit. Përdorimi i VATS-it në këta raste, ishte vetëm me qëllime diagnostifikuese, e jo kurative.

Ndërsa një grup i vogël tjetër, që edhe kundrejt aplikimit të gjitha metodave diagnostifikuese, nuk aritëm që të bëjmë diagnostifikimi dhe staxhingun e mire, e sëmundjes ishim të detyruar, që të njejtë t'i nënshtrorjmë në torakotomi eksplorative, ku gjatë intervenimit kirurgjikal u morë, material biologjik për egzaminim dhe u bë biopsi ex tempore, e më pas, pas marrjes së rezultateve, u vendos për trajtimin e mëtejshëm të pacientit.

Ajo që është me rëndësi, në trajtimin e mëtutjeshëm të karcinomit të mushkërisë, kuptohet që në përzgjedhjen e mënyrës së kurimit. Protokollin që do të ndiqet në llojin dhe volumin, e përfshirjes së kurimit, metodologjisë së veprimit është ai i diferencimit histologjik i karcinomit të mushkërive, gjithsesi ajo bëhet me metoda joinvazive dhe ato invazive, me qëllim të njejtë një diferencimi sa më të mirë histologjik, që luan rolin e vet në trajtimin e mëtutjeshëm të karcinomit të mushkërive.

Në këtë procedurë diagnostifikuese rolin e vet të pazavendueshëm gjithsesi e ka mjeku patolog, që bën diagnostifikimin apo përshkruan tipin histologjik të karcinomit të mushkërive.

Me diagnostifikimin histologjik të karcinomit të mushkërive dallojmë katër lloje edhe ato:

- Planocelular (epidermoid, skuamoz)
- Adenokarcinomë
- Makroceluarë
- Mikrocelularë (small cell carcinoma)

Nga diferencimi histologjik i karcinomit të mushkërive, kualiteti i së cilit mvaret drejtëpërdrejtë nga patologu që bën këtë egzaminim, në masë të madhe mvaret mënyra e trajtimit të pacientit.

Kjo duhet të shënohet nga rëndësia e veçantë e këtij veprimi, pasi që fillimisht, është udhërefyesi i parë i drejtimit mjeksor, që në mënyrë duhet të ndjekim dhe të kanalizojmë veprimet tona, të drejtojmë dhe ndjekim protokollin përkatës.

Tre grupet e para Patohistologjike të karcinomit të mushkërive, paraqesin karcinom qelizë madhe, apo në nomenklaturën ndërkombëtare NSCLC (non small cell lung cancer) dhe paraqesin

grupet e pacientëve, që janë objekt i këtij studimi ku edhe është bërë gradacioni apo stagingu i karcinomit të mushkërive, nga e cila rezulton edhe mënyra e kurimit të tij.

Pasi që bëhet diagnostifikimi i karcinomit të mushkërive, më pas definohet lloji e më vonë bëhet edhe stagingu, në bazë të këtyre të dhënave ekipi mjeksor bënë edhe vendosjen e protokolit, që do të ndjekë në kurimin e kësaj sëmundje malignje. Siç u cek edhe më lartë në grupete pacientëve, që ne i analizuam në këtë disertacion janë të tre grupeve të para në karcinomit apo të NSCLC.

Grupi i katër i karcinomit mikrocelular paraqet sëmundje sistematike që në masë të madhe trajtohet në mënyrë konzervative, me terapi simptomatike dhe hemoterapi një përqindje shumë e vogël mund të nënshtrohet intervenimit kirurgjik.

Për trajtimin kirurgjik, të pacientëve me karcinom të mushkërive dhe vendosjen, të indikacionit për intervenim, së pari bëhet një vlersim i mirë kardiologjik.

Në rast të problemeve kardiologjike, sugjerohet zgjedhje e përkohshme apo e përhershme e problemit kardiologjik nga ana e kardiologut përgjegjës.

Gjithsesi në vlersimin kardiologjik, që sugjerohet për përgatitje paraoperative të pacientëve me karcinom të mushkërive, bën pjesë një egzaminim bazik i:

- elektrokardiografisë, më pas
- eksonografi e zemrës

Me dopler të saj dhe kuptohet, me vlersimit të frakcionit ezhektiv të zemrës.

Në grupin e pacientëve, që nuk rekomandohet intervenim kirurgjik imediat, bëjnë pjesë edhe pacientët që kanë pësuar infarkt të miokardit, deri në 6 muaj më parë, pacientët që frakcionin ezhektiv e kanë më të vogël se 40% (FE<40%).

Këta grupe pacientësh, gjithsesi në fazë të parë nuk rekomandohen, për intervenim kirurgjik. Të njëjtët kuptohet në kordinim me kardiologët, rekomandohet trajtim i tyre, kardiologjik dhe më pas më së paku në afat pre tre muajsh, një evaluim i përsëritur i gjendjes kardiologjike dhe më pas, të bëhet vlersimi i trajtimit të mëtuqjeshëm kirurgjik të mundshëm.

Vlersimi tjetër, që është jashtëzakonisht i rëndësishëm, në veçanti kur bëjmë fjalë për intervenimet kirurgjike, të mushkërive e sidomos të atyre të karcinomit të mushkërive, është ai i kapacitetit maksimal të mushkërive dhe rezervës pulmonale, kuptohet se ky vlersim spirometrik, i

volumit të mushkërive është jashtëzakonisht i vlefshëm, për rrugëtimin e pacientit në rehabilitimin e tij postoperativ.

Një vlersim jo i mirë i kapacitetit pulmonal, që do të rezultojë me rezerva gasore të pamjaftueshme, më pas do të sjellte probleme serioze shëndetsore postoperative tek pacienti, që do të rezultonte me një mbarim fatal për pacientin.

Kontraindikacione tjera, për intervenim kirurgjik janë angina pectoris jostabile, stenozeë shprehur e aortës, A-V blok në shkallë të lartë, dekompenzimi i zemrës në shkallë të lartë.

Në këtë grup të vlersimeve, paraoperative të pacientëve gjithsesi nuk duhet anashkuar, edhe principet e përgjithshme të trajtimit kirurgjik dhe të vlersimit para operativ, në kuptim të vlersimit të gjendjes së përgjithshme, alergjite e mundshme, komorbiditetet siç janë diabeti, hiopertensionit, sëmundjet hematologjike, sëmundjet sistematike autoimune, etj.

Protokolet bashkohore, në trajtimin kirurgjik të karcinomit të mushkërive së pari përfshinë, tre cikle të hemoterapisë induktive, qëllimi i së cilës është që masa e karcinomit të mushkërive të zvoglohet, gjëndrat limfatike të zvoglohen, metastazat e mundëshme, qoftë regjionale apo të disseminuara, të zvoglohen apo të zhduken.

Nëse bëhet fjalë për rast inioperabil, të sjellet në fazë të operabilitetit apo të zvoglimit të radikalitetit kirurgjik të pacientit.

Për vendosjen e indikacionit, për trajtim kirurgjik gjithashtu, duhet të bëhet staging i sëmundjes, e cila bëhet në bazë të përhapjes, së karcinomit të mushkërive me anë të **TNM klasifikimit** të pranuar ndërkombëtarisht si mënyrë staxhingu dhe gjatë këti vlersimi meren parasyshë tumori, madhesia e tij, gjëndrat limfatike lokale dhe regjionale, dhe metastazat e mundëshme dhe ndiqet kjo metodologji e vlersimit:

- T – Tumori primar
- N – gjenja e gjëndrave limfatike lokale e regjionale
- M – metastazët e largëta



Ndërsa stadifigimi mund te bëhet me mediastinoskopi apo ne bazë të TNM klasifikimit bëhet me anë të sistemit të vendosur ne Mountain më 1997 vje që është si vijon:

Karcinom okult	Tx N0 M0
Stadi 0	Tis N0 M0
Stadi Ia	T1 N0 M0
Stadi Ib	T2 N0 M0
Stadi IIa	T1 N1 M0
Stadi IIb	T2 N1 M0
	T3 N0 M0
Stadi IIIa	T3 N1 M0
	T1 N2 M0
	T2 N2 M0
	T3 N2 M0
Stadi IIIb	çdo T N3 M0
	T4 çdo N M0
Stadi IV	çdo T çdo N M1

Kontraindikacion intraoperativ për kryerje të intervenimi radikal kirurgjik është karcinozë e pleurës që paraqitet në 2-5%, infiltrim në stuktura regjionale, metastaza ekstrakapsulare ekstenzive ne gjendrat linfatike, Infiltrimi i strukturave të hilusit.

Në prognozën e rrjedhjes së sëmurjes kanë rol disa faktor si klinik, biologjik apo gjenetik, ne suaza te karakteristikave të të sëmurit, lokalizimi i tumorit, madhesia e tij, tipi hisologjik i karcinomit, parametrat laboratorike, mosha, gjinia, herediteti, markerët e proloferimit, të diferencimit, gjeni p53 suspensor i tumorit etj.

Pas përgaditjes dhe evaluimit të mirëfillt të pacientit dhe kuptohet nëse ka patur nevojë edhe terapisë inductive që u aprovua tek grupi i dytë i pacientëve tanë, pacientët nënshtorhen intervenimit kirurgjik të menjanimit të masës tumoroze.

Në pajtim me rekomandimet dhe protokolet basjkëkohore të trajtimit kirurgjik të karcinomit NSCLC në të dy grupet që u studjuan nuk u bë asnjë pulmektomi

Intervenimi kirurgjik që u bë në trajtimin kirurgjik tek të dy grupet e pacientëve ishin lobektomi dhe bilobektomi rezultate që do të përshkruhen më poshtë në këtë punim.

Së fundi pacienti pas intervenimit kirurgjik me karcinom të mushkërive, me terapi inductive të kaluar apo pa të duhet të trajtohet dhe me të shpëtohet në institucion onkologjik.

## 5. PËRGADITJE PARAOPERATIVE MANEVRUESE TË SISTEMIT RESPIRATOR

Regjimi i përgatitjes respirative përbëhet nga pesë elemente: ndërprerja e duhanit, dilatacioni i rrugëve të ajrit, zbutja dhe mënjanimi i i sekrecionit dhe përmisimi i edukimit dhe motivimit, të lehtësohet kujdesi postoperativ.

### 5.1. Nderprerja e duhanit

